



STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION
AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

MINISTRIA E INOVACIONIT & TEKNOLOGJISË

Zhvillimi i sektorit të
teknologjisë dhe inovacionit
përmes themelimit të Ministrisë
së Inovacionit dhe Teknologjisë

DOKUMENT POLITIKASH

përgatitur nga Besim Iljazi & Emrush Ujkani

Prishtinë, Gusht 2014

Mbështetur nga:

spark
ignites ambition

Themelimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Teknologjisë do të:

- rrisë efikasitetin e administratës dhe institucioneve (arrijë potencialin e plotë të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe bizneseve);
- ndihmojë zhvillimin e sektorit të teknologjisë, rrisë punësimin në këtë sektor, përmirësojë shërbimet e administratës, zvogëlojë shpenzimet, ...;
- ndihmojë inovacionin, hulumtimin dhe kërkimin.

HYRJE

Misioni primar i STIKK është që të avokojë për të mirën e sektorit të TI-së dhe të anëtarëve të saj. STIKK është shoqatë industriale që grupon 120 kompani të TI-së, 5 universitete që kanë programe të TI-së, dhe 3 shoqata të specializuara në lëmi të caktuara të TI-së. Por deri më tani, STIKK nuk e ka një partner brenda qeverisë ku mund t'i adresojë brengat, qëndrimet, dhe rekomandimet në lidhje me sektorin e TI-së. Shpresojmë se ky dokument do të ndihmojë në sqarimin e nevojës për themelimin e Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit.

STIKK beson se mungesa e një Ministrie për Teknologji dhe Inovacion është bërë pengesë për zhvillimin e sektorit të TI-së në Kosovë, dhe një prej pengesave të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës, rritjes së punësimit dhe përafrimit me rajonin dhe me Evropën. STIKK beson se vetëm një Ministri për Teknologji dhe Inovacion, që duhet të formohet nga agjencionet dhe departamentet ekzistuese të TI-së brenda institucioneve të Kosovës, mund të ndikojë që sektori i TI-së të fillojë të rritet në potencialin e tij të vërtetë i cili do shërbente si një resurs potencial, madje jo vetëm për Kosovën por edhe për rajonin e më larg, në avancimin e ofrimit të shërbimeve më të avancuara nga sektori i teknologjisë informative.

ANALIZA

Sektori i teknologjisë dhe inovacionit në Kosovë është i rregulluar nga një listë e ligjeve që jo rrallë kanë mbulim dhe përsëritje të kompetencave me njëri tjetrin e që zbatohen nga një numër i institucioneve që fare, ose fare pak, janë të koordinuara në mes tyre. Nga këto institucione, janë tri më kryesore në të cilat është shkapërderdhur bërja e politikave të TI-së në Kosovë:

- Politikat për sektorin e telekomunikacionit, TI-së, e së fundmi edhe të “shoqërisë së informacionit”¹ hartohen nga Departamenti i TI-së brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;
- Politikat për teknologji dhe për edukimin për teknologji, për inovacionin dhe për kërkimin dhe hulumtimin në TI bëhen nga Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë brenda Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Politikat institucionale, pra për përdorim të TI-së brenda institucioneve, hartohen nga Departamenti i TI-së brenda Ministrisë së Administratës Publike, që me ligjin e fundit quhet Agjencioni për Shoqëri të Informacionit².

Se këto departamente nuk janë të koordinuara si duhet tregon fakti se një departament i TI-së bën politika për “shoqëri të informacionit” pra, politika që prekin tërë shoqërinë, kurse tjetri departament që mban pikërisht emrin “... për shoqëri të informacionit”, nuk i bën këto politika por bën politika për TI dhe atë për përdorim vetëm brenda institucioneve. Ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) praktikisht kurrë nuk arriti të shkronja T – Teknologjia që e mban në titull të saj. Se kjo ministri ka departamentin për teknologji dhe tri divizione brenda tij: për “shkencë”, për “teknologji” dhe për “inovacion dhe transfer të teknologjisë”, mund të kuptohet vetëm nga ueb faqja e ministrisë³, por jo edhe nga ndonjë efekt i prodhuar në praktikë. Vetë misioni⁴ i këtij departamenti duket mjaft i paqartë dhe i zbehtë, në rastin më të mirë në funksion të A-së së kësaj ministrie, arsimit.

Nga të tri këto institucione, Agjencioni për Shoqëri të Informacionit ka peshën më të madhe. Kjo vjen nga fakti se, ky agjencion ka buxhetin më të madh për TI brenda qeverisë dhe, duke qenë se institucionet shtetërore janë klienti më i madh i TI-së në vend, kërkesat e TI-së nga këto institucione përcaktojnë edhe ofertën që sektori i TI-së duhet ta japë por përcaktojnë edhe profilin e studentëve që duhet të prodhojë sistemi arsimor për t’i shërbyer këtij sektori.

Por kjo nuk mjafton. Me ligjin NR. 04/L-145 Agjencisë së porsakrijuar për Shoqëri të Informacionit nuk iu dha ndonjë kompetencë mbi ato që veçse i kishte departamenti prej të cilit

¹ Strategjia Nacionale për Shoqëri të Informacionit 2006-2012 http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia_Nacionale_per_Shoqeri_te_Informacionit_2006-2012.pdf

² Ligji Nr. 04/L-145, Për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669>

³ Struktura organizative – organogrami në ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë http://masht-gov.net/advCms/documents/organogrami_shqip_15_11_2013.pdf

⁴ Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë, MASHT <http://masht-gov.net/advCms/#id=36>

u formua ky agjencion. Me këtë ligj kjo Agjenci nuk fitoi kompetenca që të bëjë politika gjithëkombëtare për shoqërinë e informacionit, nuk fitoi kompetenca që të shqyrtojë se a janë projektet e TI të propozuara nga institucionet e tjera në harmoni me këto politika gjithëkombëtare, nuk fitoi kompetenca që të aprovojë projektet e TI të propozuara nga institucionet qeveritare duke përfshirë këtu aprovimin e buxhetit të këtyre projekteve, dhe nuk sinkronizoi të gjithë politikëbërjen për TI duke e bashkuar atë nën një institucion. Ligji Nr. 04/L-145, Për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, me të cilin departamenti i TI-së brenda MAP u ngrit në Agjencion për Shoqëri të Informacionit prodhoi vetëm një efekt real: atë të ndryshimit të emrit të departamentit.

Ideja për formimin e organeve qeveritare për shoqëri të informacionit u zhvillua nga Iniciativa eSEE – një instrument i Paktit të Stabilitetit për Ballkanin. Kosova zyrtarisht bëhet pjesë e kësaj iniciative në konferencën ministrore në Selanik, në vitin 2005, me ç’rast u nënshkrua Memorandumi dhe Konkluzionet e Konferencës Ministrore për Shoqërinë e Informacionit. Dokumentet në emër të Kosovës u nënshkruan nga përfaqësuesi i UNMIK, Joachim Rucker. Meqenëse Kosova u bë anëtare e fundit dhe shumë më vonë se shtetet e rajonit, në konkluzua u caktuan edhe datat e sakta për Kosovën që të ndërmarrë veprime që shtetet tjera të rajonit veçse i kishin përfunduar.

Veprimet që Kosova u pajtua t’i ndërmarrë ishin, me radhë: aprovimi i strategjisë për shoqëri të informacionit në bazë të udhëzimeve të përgatitura nga grupi punues i eSEE – deri në mars 2006, formimi i organeve qeveritare për shoqëri të informacionit – deri në mars 2006, miratimi i kornizës ligjore për nënshkrimin elektronik – deri në mars 2006, kornizës ligjore për e-Commerce – mars 2006, ligjit për krimin elektronik – qershor 2006, ligjit për telekomunikacionin – qershor 2—6, dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale – qershor 2006.

Me përjashtim të ligjit për telekomunikacionin që ishte miratuar më 2003, Kosova nuk i kreu në kohë asnjë prej veprimeve për të cilat u dakordua se do t’i bënte. Ligji për Organet për Shoqëri të Informacionit u aprovua në Kuvendin e Kosovës tek më 18 prill 2013.⁵ Kurse versioni i ligjit që u miratua u zhvesh nga shumica e çështjeve të rëndësishme për të cilat ky ligj duhej të miratohej në radhë të parë e që ishin të precizuara në dokumentet e eSEE të udhëzimeve⁶ për këtë ligj.

Arsyeja pse u ndryshua përmbajtja e ligjit ishte e njëjtë me atë pse u shty hartimi dhe miratimi i këtij ligji: rezistenca e departamenteve dhe institucioneve ekzistuese ndaj ristrukturimit, pa marrë parasysh se ristrukturimi do të krijonte një rritje tepër të madhe të efikasitetit. Ligji përfundoi duke krijuar një agjencion të ri, nga një departament ekzistues, pa i dhënë asnjë

⁵ Ligji Nr. 04/L-145, Për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669>

⁶ Stability Pact, Terms of Reference Information Society State Bodies <http://www.stabilitypact.org/e-see/tor%20IS%20State%20Bodies.pdf>

kompetencë të re, dhe pa bërë konsolidimin me departamentet e tjera e ku vazhduan të mbesin shumica e kompetencave të cilat me ligjin e ri duhej të konsolidoheshin në një organ.

Arsyet formale për “zvogëlimin” e këtij ligji - zvogëlimin e rolit dhe fuqisë së Agjencionit për Shoqëri të Informacionit, mund të kenë qëndruar në analizat e mangëta mbi shpenzimet, si p.sh. duke pohuar se ristrukturimi në një ministri të re do të kërkonte objekt të ri që faktikisht dhe fatkeqësisht ende është *modus operandi* i mentalitetit se si duhet të funksionojnë institucionet shtetërore, se do të duhej të punësoheshin njerëz të rinj për ministrinë e re e që rritja e numrit të shërbyesve civilë do të kundërshtojë fuqishëm, përfshirë këtu nga FMN, e të ngjashme.

Arsyeja e vërtetë do të ketë qenë frika nga ndryshimet, dhe ruajtja e fuqisë dhe pozicioneve aktuale në strukturën e institucioneve. Vendimmarrësit u vendosën në pozitë të zgjedhin në mes të panjohurës së ndryshimit që premtonte se do të rriste efikasitetin e politikëbërjes dhe të shërbimeve të TI-së për të mirën e publikut, dhe rrezikut të vërtetë se pozicionet e etabluara të fuqisë brenda strukturave ekzistuese do të shembeshin. Dhe vendimmarrësit zgjedhën *status quo*-në. Në këtë dritë, nuk befason as fakti se pse mungoi një debat publik për projektligjin për Organet për Shoqëri të Informacionit.

STIKK beson se Ligji për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit është dashtë të nxirret shumë më herët, jo vetëm për shkak të presionit të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara, por për shkak se ristrukturimi dhe formimi i një Ministrie për Teknologji dhe Inovacion është nevojë si për qeverinë ashtu edhe për sektorin e TI-së. Mbledhja e departamenteve ekzistuese të teknologjisë nën një kulm do të bëjë fokusimin e kapaciteteve të kufizuara brenda qeverisë në një drejtim e jo në tri ose më shumë si është sot, rrjedhimisht do të rrisë efikasitetin dhe kualitetin e politikëbërjes dhe do të sigurojë se buxheti i ndarë për TI shpenzohet konform strategjive të miratuara në nivel të tërë qeverisë.

Formimi i Ministrisë së re të Teknologjisë dhe Inovacionit nuk kërkon as ndërtesë të re e as njerëz të rinj për të punësuar. Ajo çka mungon është koordinimi i punës së tyre, bashkimi i tyre në të njëjtin ekip, dhe një mandat dhe përgjegjësi e ngritur që të ndihmojnë dhe mundësojnë shfrytëzimin e potencialit që e ka teknologjia informative si për zhvillimin ekonomik ashtu edhe për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

ASPEKTET KRAHASIMORE

Për të themeluar një ministri e cila do mbulonte sektorin e teknologjisë informative dhe atë të inovacionit gjithsesi është e nevojshme të shikohen edhe eksperiencat e vendeve kryesisht nga rajoni për të parë se si ky sektor koordinohet në nivel qeveritar. Pasi që esenca kryesore e këtij dokumenti konsiston në ofrimin e argumenteve të nevojshme të cilat flasin për nevojën e themelimit të një Ministrie që do të mbulojë sektorin e teknologjisë informative dhe atë të inovacionit, atëherë më poshtë po listojmë vetëm disa nga eksperiencat e vendeve të rajonit. Natyrisht këtu vetëm do përmendim emërtimin e këtyre institucioneve dhe rolin e tyre në sektorin e teknologjisë informative dhe atë të inovacionit.

Qeveria e Malit të Zi ka të themeluar Ministrinë për Shoqëri të Informacionit dhe Telekomunikacionit. Përveç sektorit të telekomunikacionit kjo ministri ka për detyrë zhvillimin e politikave dhe dokumenteve strategjike lidhur me sektorin e teknologjisë informative si dhe njëkohësisht zbatimin e këtyre dokumenteve.⁷

Bosnja dhe Hercegovina në vitin 2003 ka themeluar Ministrinë për Komunikim dhe Transport. Kësisoj zhvillimi i sektorit të teknologjisë informative paraqet një rën nga përgjegjësit kryesore të kësaj ministrie së bashku me atë të transportit.⁸

Në Shqipëri është e themeluar Ministria për Inovacion dhe Administratë publike. Misioni i kësaj ministrie konsiston në hartimin dhe bashkërendimin e politikave në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike, të infrastrukturës së informacionit gjeo-hapësinor, në shërbimet postare, mediat audiovizive dhe për reformimin dhe modernizimin e administratës publike.⁹

Në Maqedoni ekziston Ministria e Shoqërisë Informative dhe njëri nga funksionet kryesore të kësaj ministrie konsiston në zhvillimin dhe koordinimin e politikave nga sektori i shoqërisë informative. Gjithashtu kjo ministri ka për detyrë zbatimin e dokumenteve strategjike të miratuara lidhur me sektorin e shoqërisë informative.¹⁰

Në Republikën e Serbisë politikën lidhur me shoqërinë informative e zhvillon dhe koordinon Ministria e Kulturës dhe Informacionit.

Nga kjo që shohim nga të gjitha vendet e rajonit vetëm Republika e Kosovës nuk ka një ministri e cila edhe nga vetë emërtimi i saj do të kuptohej se është përgjegjëse për zhvillimin e këtyre sektorëve. Një fakt i tillë sa do që është shqetësues në të njëjtën kohë është një argument i fuqishëm për nevojën e themelimit të Ministrisë së inovacionit dhe teknologjisë informative.

⁷ Ministria për Shoqëri të Informacionit dhe Telekomunikacion <http://www.mid.gov.me/en/ministry>

⁸ Ministria për Transport dhe Komunikim <http://www.fmpik.gov.ba>

⁹ Misioni i Ministrisë për Inovacion dhe Administratë publike <http://www.inovacioni.gov.al/al/ministria/misioni>

¹⁰ Ministria për Shoqëri Informative e Maqedonisë <http://www.mio.gov.mk/?q=frontpage>

REKOMANDIMET

Duke u nisur nga përvojat e vendeve të rajonit si dhe duke marrë shkas nga fakti se me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të sektorit të teknologjisë informative si dhe atë të inovacionit në Republikën e Kosovës, STIKK mendon se:

- Mbështetur në përvojat e vendeve të rajonit (të listuara më lartë) ne konsiderojmë që hapi i parë që duhet ndërmarrë nga Qeveria e re është që me vendim politikë Agjencionin e Shoqërisë së Informacionit ta shndërroj në Ministri të Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Po ashtu me vendim Qeveria e Kosovës duhet të përcaktoj kompetencat e Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe vetë përgjegjësit e ministrit të kësaj ministrie;
- Ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të jetë institucioni i vetëm i cili miraton dhe zbaton politika konkrete në fushën e teknologjisë informative dhe inovacionit;
- Në momentin e themelimit të Ministrisë përgjegjësit të cilat ndërlidhen me politikë bërjen në sektorin e teknologjisë informative (Departamenti i TI-së brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik) dhe në fushën e inovacionit (Departamenti i Teknologjisë brenda Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë) duhet t'i bashkohen ministrisë së re;
- Një nga përgjegjësit kryesore të Ministrisë së Teknologjisë dhe Inovacionit do jetë edhe përgatitja dhe propozimi i buxhetit vjetor për sektorin e teknologjisë informative dhe inovacionit;
- Ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të jetë përgjegjëse për hartimin dhe bashkërendimin e politikave për avancimin dhe zhvillimin e sektorit të teknologjisë informative dhe atij të inovacionit;
- Ministria e Teknologjisë dhe Inovacionit duhet të ndërmarrë masa konkrete për lehtësimin e të gjitha politikave dhe procedurave administrative, masave fiskale dhe jo fiskale të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në zhvillimin e sektorit privatë të teknologjisë informative, i cili do jetë i aftë të jetë i konkureshëm jo vetëm me vendet e rajonit por edhe më larg.

Rr. Rexhep Mala, 28A
10000 Prishtine, Republika e Kosoves
Tel. +381 38 77 11 80 ext. 501

info@stikk-ks.org, www.stikk-ks.org



[/STIKK.Official](https://www.facebook.com/STIKK.Official)



[/STIKK_Ks](https://twitter.com/STIKK_Ks)



[/company/STIKK](https://www.linkedin.com/company/STIKK)